

VENDIM
Nr. 71, datë 26.3.2018

**MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 124, SERIA T11P SHOQËRISË “HEC DUNICË” SHPK
PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s
NR. 28, DATË 10.3.2011**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germat “ç”, “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”, nenit 18 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 5, germat “ç”, “d” dhe “dh”, neni 9 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 54, datë 18.4.2017, pika 5.1, germat “d” dhe “dh” të kushteve të “Licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, si dhe nenit 9, pika 9.3, të rregullores “Për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit me nr. 190, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, pasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k. me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011,

konstatoi se:

- Shoqëria tregtare “HEC Dunicë” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 8 prot., datë 19.1.2018, protokolluar me tonën nr. 104, datë 23.1.2018, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 37, datë 9.2.2016, ka filluar procedurën për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., me nr. 123, seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE, me shkresën nr. 104/3 prot., datë 23.2.2018, ka njoftuar subjektin “HEC Dunicë” dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimmarrjen e Bordit dhe pas përfundimit të afatit ligjor të pritjes së komenteve nga palët, nuk ka pasur asnjë reagim.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017, drejtuar shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k. dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Bimëve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka njoftuar për zgjidhjen e kontratës së konçensionit me nr. 2059 rep., dhe nr. 248/1 kol. datë 16.6.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve në pellgun e lumit Dunicë, Pogradec. Kjo kontratë është lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vortek” sh.p.k. dhe “By Best Duty Free” sh.p.k. dhe autoritetit shtetëror ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

- Subjekti referuar shkresave të komunikimit në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017 dhe shkresën me nr. 46/51 prot., datë 14.6.2017, rezulton se është në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin e tregtimit dhe për rrjedhojë kërkon heqjen e licencës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 18.12.2017, ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2017. Bashkëlidhur listës për subjektet e licencuara në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton edhe subjekti “HEC Dunicë” sh.p.k. me nr. 16 rendor, dhe për vitin 2017 i përkon pagesa rregullatore, në shumën 40 000 lekë.

- Referuar rrethanave të sipërcituara, subjekti “HEC Dunicë” rezulton në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin dhe ka kërkuar heqjen e licencës dhe e pagesës së rregullimit për vitin 2017, bazuar kjo në pikën 1, germa “ç”, të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 9, pika 9.3, të rregullores “Për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 190, datë 23.11.2017.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën nr. 124, seria T11P, shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k., për tregtimin të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011.

2. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k., për heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017, në shumën 40 000 lekë, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë shoqërinë "HEC Dunicë" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti